

VENDIM
Nr. 2589/3, datë 4.10.2019

PËR REZULTATIN E ZGJEDHJEVE DHE SHPALLJEN E FITUESIT

Në mbështetje të nenit 115, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Votimit me përbërje:

Thoma Jano, kryetar;

Alma Muça, anëtar;

Bilbil Mete, anëtar,

pasi administroi gjithë dokumentacionin e votimit, numëroi votat, përpiloi procesverbalin përkatës,

VËREN:

Në përfundim të procesit të votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e 1 (një) prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku morën pjesë në votim 253 (dyqind e pesëdhjetë e tre) prokurorë, kandidatët sipas numrit më të madh të votave, renditen si vijon:

Znj. Esmeralda Keshi (Cami) 133 vota;

Z. Vladimir Mara 109 vota.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenin 115, paragrafët 5 e 7, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 15 të rregullores së Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, Komisioni i Votimit,

VENDOSI:

1. Të shpallë fitues prokurorin e prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, znj. Esmeralda Keshi (Cami).

2. Ky vendim të shpallet zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme.

3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më datë 4.10.2019.

KOMISIONI I VOTIMIT

Kryetar: Thoma Jano

Anëtare: Alma Muça

Anëtar: Bilbil Mete